

I nderuar Zoti kryetar i komisionit
Te nderuar zonja dhe zoterinj deputetë,

Nëse nuk ka kulturë nuk ka zhvillim, - biem të gjithë ne nje mendje kur flasim me njeri-tjetrin dhe kur tema e bisedes eshte vetem kultura.

Por kur biseda fillon me shqetesimin per zhvillimin ajo nuk vazhdon më me kulturën por me ekonominë si e vetmja shtylle qe mban njerezimin ne kembe.

Kultura kthehet keshtu ne nje apendix, i parendesishem, ose me se shumti si çeshtje qeji pa te cilen edhe mund te behet.

Me kete logjike simpliste, per kulturen nuk harxhohen para.

Shqipëria është një vend i pasur në trashëgimi kulturore, të të gjitha epokave e prej shumë origjinash, duke mos krijuar kështu asnjë kompleks inferioriteti përballë qytetërimeve të tjera që e rrethojnë dhe me të cilat ndan sot jo vetem kufij por sidomos hapësira, gjeografike, ekonomike, hapësira bashkepunimi dhe hapësira njerëzore.

Kjo hapësire e hapur e sjell kulturen dhe diversitetin e saj brenda tendencave globale te zhvillimit te ekonomisë.

Turizmi kulturor eshte korniza e pershtatshme per kete lloj rigjenerimi.

Nuk ka dyshim se Shqipëria me pasurinë kulturore qe ka duhet ta ndjeke këtë model duke ruajtur origjinalitetin dhe diversitetin e vet.

Kjo kërkon politika kurajoze, platforma inovative dhe aksione të planifikuara.

Në Shqipëri si dhe në vende të tjera të Ballkanit trashëgimia kulturore krijon mundësi për të nxitur dhe aktivizuar rrjete të mirash dhe shërbimesh, instrumente ekspansioni ekonomik dhe social si në terma sasiorë ashtu edhe në terma cilësorë.

Nga ana tjetër jemi të ndërgjegjshëm që mirëmbajtja dhe konservimi i TK eshte nje operacion pa mbarim dhe i rëndë financiarisht qe shteti, dhe ne fakt jo vetëm i yni, nuk do të mund ta përballonte dot i vetëm. Prandaj nje qasje e re ekonomike pa demtuar vlerat e kesaj pasurie kombetare eshte e nevojshme. Kjo nënkupton përfitimin e një vlere të shtuar, si rezultat e ofrimit të shërbimeve të tjera që kanë natyrë të pastër ekonomike, të karakterit produkt shërbimi.

Por kjo duhet bere vetem në kushtet e zhvillimit ekonomik dhe industrial, jo me një ekonomi që rëndon por me një ekonomi që mendon.

Shoqëruar me

- informimin dhe sensibilizimin e popullsisë
- edukimin e rinise me dashurinë per TK dhe mbrojtjen e saj.

nisma si portali "shpetothesarin.com" apo krijimi i rrjetit "Miqte e trashegimise" qe do te organizojme ne bashkepunim me Ministrine e arsimit dhe shkollat, i sherbejne kesaj filozofie.

Por që të biem TK në një situatë të tillë interesante për partneritete të tilla, nderkohe na duhet ta shpetojme nga rreziqet qe i kanosen, dhe që i kanë sjelle ne keto vitet e fundit, objektet, qendrat dhe parqet e saj rregullisht ne qender te vemendjes se medias dhe opinionit publik.

Kjo është arsyeja pse një nga vendimet e para të qeverisë së re, është frenimi i së keqes, me dy vendimet e fundit të Këshillit Kombëtar të Territorit:

- moratoriumi per të ndaluar ndërtime në 3 qytetet që janë qendra historike: Kruja, Gjirokastra dhe Berati, duke shtuar këtu që këto dy të fundit janë qytete-pjesë e listës së trashëgimisë botërore

- dhe pezullimi i dhenies së lejeve të ndërtimit deri në hartimin e Planit të përgjithshëm të territorit, në zonat e mbrojtura të trashigimise kulturore.

Trashëgimia nuk është "nature morte", por habitat njerëzor, ku historia e së shkuarës lidhet me jetën moderne.

Vetëm një zhvillim i kontrolluar dhe i koordinuar në dimensionet e veta ekonomike, mjedisore, sociale mund ta shpëtojë kulturën dhe trashëgiminë e saj, për ta kthyer në burim ekonomie, për ta rivendosur në peizazhin e vet natyror dhe arkitektonik dhe për ta rivitalizuar në përfitim të shoqërisë dhe të komunitetit.

Dhe zhvillimi nuk është vetëm atribut i majës së piramidës së pushtetit, por edhe veprimtari e bazës së saj. Në fushën e trashëgimisë kulturore, menaxhimi territorial i saj merr një rëndësi të dorës së parë.

Sensibilizimi i popullsisë, rivlerësimi moral i trashëgimisë kulturore, e më pas responsabilizimi i administratorëve në territor, mundësia e përfitimit nga komuniteti, dhe sistemi i kontrollit kapilar duke mbuluar gjithë territorin, krijon atmosferën e nevojshme për ruajtjen dhe rivitalizimin e trashëgimisë kulturore, dhe ekuilibrin ekonomik-social të qendrueshëm.

Duhet nje pune shume e madhe dhe riorganizim ligjor dhe administrativ - (kantier qe e kemi hapur tashme) - per ta mbajtur Trashëgimie ne qender te vemendjes jo më duke leshuar thirrje per ndihme por duke kryer nje reforme per ta ringritur ate si nje vlere e mbrojtur dhe pasuri kombetare.

Une vete me ekipin tim e kam filluar punen me nje analize te detajuar te situates, jo vetem dosje per dosje dhe te kuadrit ligjor ekzistues, por duke qene ne kontakt e komunikim te vazhdueshem me komunitetin e profesionisteve te TK si dhe duke zhvilluar nje tur te perjavshem levizjesh ne terren i cili do te vazhdoje deri sa t'i kem prekur te gjitha qendrat e mbrojtura dhe parqet, per t'u takuar me stafin qe punon atje e per te kuptuar problemet reale te menaxhimit ne terren, per te biseduar me perfaqses te pushtetit lokal dhe per te pare gjendjen fizike te zonave qe cilesohen si zona te TK.

Në vijim te kesaj fryme analitike duhet thene se sistemi aktual i menaxhimit të TK në Shqipëri kërkon një reformë të shumë aspekteve: ligjor, organizativ, teknik dhe ekonomik. Duke adoptuar forma të njëjta të menaxhimit të TK kemi zgjedhur e zgjidhur kështu një nga menytrat per t'u integruar ne BE.

Kjo është arsyeja pse Ministria e Kulturës, tashme e dedikuar per kulturen, në bashkëpunim me të tjera ministri siç është

- ajo e turizmit dhe planifikimit urban me të cilen jemi në komunikim të vazhdueshem,

- ministria e brendshme me te cilën po ndërtojmë ura komunikimi për ruajtjen dhe mbrojtjen e TK nga keqberësit dhe abuzuesit, duke pergatitur nje program trainimi te specializuar per kete figure krimi te veçante qe eshte krimi kunder objekteve dhe monumenteve te TK. Jemi ne kontakt me partnere nderkombetare dhe me perfaqses te Komisionit European te cileve u kemi kerkuar asistence per kete gje.

Ky është një detyrim që rrjedh edhe nga Konventa UNESCO e Parisit 1970 “Konventa mbi mjetet e ndalimit dhe parandalimit të importit dhe eksportit të paligjshëm dhe transferimit të pasurive kulturore” (ratifikuar me 13.06.2002 hyrë në fuqi me 13.09.2002). Në veçanti Neni 5 i kësaj Konvente parashikon impenjimin e vendeve anetare për të krijuar në terren personel të kualifikuar, për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore me qëllim mbrojtjen e objekteve të trashëgimisë kundër importimit, eksportimit dhe ndryshimit në mënyrë të paligjshme të pronësive mbi to. Ky program do të përfshijë si punonjës të policisë ashtu edhe personel të specializuar të Qendres së inventarizimit të pasurive kulturore dhe të IMK.

Krijimi i kësaj/ketyre njesive, apo berthame do të sigurojë:

- Krijimin dhe përditesimin e bankës së të dhënave të objekteve të trashëgimisë kulturore
- Kontrollin e germimeve arkeologjike dhe masat për konservimin e tyre;
- Vendosjen e rregullave të sjelljes konforme etikes dhe frymes së konventës ndaj personave të interesuar (koleksionist drejtues muzesh etj);
- Kontroll të inventareve të objekteve të levizshme qofshin ato muzeale apo të tjera duke parandaluar kështu dëmtimin apo lëvizjet e pakontrolluara të tyre.

Jemi në hapat e parë të kësaj iniciative për çka kemi dhe mbështetjen në parim të partnerëve ndërkombëtarë për programe bashkëpunimi

Ky reformim do të kryhet

- në dialog të domosdoshëm me pushtetin vendor pa të cilin s'mund të ketë zhvillim koherent dhe të qëndrueshëm,

- si dhe në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë për të përfituar nga gabimet dhe përvojat e mira të tyre, por edhe nga mundësitë e bashkëpunimit.

Ministria e Kulturës po rikoncepton sistemin strukturor TK me disa pista veprimi.

Se pari:

- ristrukturim të drejtorisë së TK brenda në Ministri duke i dhënë një hapësirë me të organizuar strukturës së përmbajtjes për të përfshirë në të administrimin dhe hartimin e politikave të qarta:

- për trashëgiminë materiale

- për trashëgiminë imateriale

me risinë e futjes së konceptit të arkitekturës dhe të peizazhit mjedisor dhe kulturor në trashëgimi.

Një tjetër parim që do të gjeje menjëherë zbatim është

- vendosja e mekanizmave të transparencës në vendimarrje,

Për këtë Ministria e Kulturës, po riformaton KKR dhe KKA, për të siguruar:

- gjithëpërfshirje të grupeve të interesit si dhe eksperte të fushës.

KKR dhe KKA e rinj, në hapat e tyre të parë, do të mblidhen për të rikonceptuar rregullat e funksionimit dhe të botimit elektronik të vendimeve të tyre në linjë.

Nga analiza e deritanishme del e domosdoshme

- vendosja e rregullave të lojës të qarta për të gjithë aktorët, dhe të raportimit e të komunikimit të përditshëm mes Drejtorive të përmbajtjes në Ministri - Drejtorive rajonale - IMK - ASHA-s, - të Institutit të Arkeologjisë si dhe të institucioneve të tjera të specializuara jashtë strukturave të varësisë por pjesë të sektorit.

Nga analiza e kryer deri tani shihet qarte se ka nje kakofoni dhe mbivendosje kompetencash qe shpesh ka ardhur jo aq prej paqartesis se ligjit kryesor por per shkak te mungeses se vullnetit, te neglizhencave individuale, te nje perqendrimi te tejskajshem te kompetencave ne njerën dore, te VKM kunderproduktive si dhe te mungeses se koordinimit nga ana e Ministrisë.

Per nje adminstrim me te mire te objekteve te TK si ne zonat e mbrojtura dhe ne zonat tampon, Ministria ka ndermarre nje plan pune per:

- riorganizimin territorial të administrimit të TK per te propozuar nje strukture te re

Kjo nisme per reforme te strukturave bazohet në :

- (1) Përvojën e deritanishme në këtë fushë ne Shqipëri, me të mirat dhe dobësitë e saj;
- (2) Përvojën më të mirë ndërkombëtare të ndare nga ekspertë ndërkombëtarë,
- (3) por edhe të përftuar përmes trajnimeve dhe vizitave studimore të organizuara në kuadrin e projekteve të ndryshme në fushën e menaxhimit të trashëgimisë;
- (4) Në propozimet konkrete të bëra nga ekspertiza e huaj në kuadrin e projekteve ne fushën e kulturës.
- (5) E mbi të gjitha në Ligjin për Trashëgiminë Kulturore të Republikës së Shqipërisë të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 "Për trashëgiminë kulturore", të ndryshuar, i cili në mënyrë të paligjshme është "goditur" nga Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.983, datë 10.11.2010

KJO NISME ka per qellim:

1. Eliminimi i mbivendosjes së kompetencave të institucioneve të specializuara;
2. Rritjen e eficeses së përdorimit të burimeve financiare dhe njerëzore;
3. Rivendosja e besimit në kapacitetin e strukturave shtetërore për mirëmenaxhimin e trashëgimisë kulturore.
4. Mbulimin me te mire te territorit ku gjenden pasurite e TK me personel mirembajtes.

II. CFARE RISISH DO TE SJELLE:

1. *Dekoncentrm të sistemit:* Ndërkohë që institucionet qendrore merren me hartimin e politikave dhe vendimmarrjen me impact të gjerë në kohë dhe në hapësirë, Drejtoritë Rajonale të Kulturës Kombëtare do të angazhohen në mirëmenaxhimin e përditshëm e harmonik të monumenteve e institucioneve të kulturës, për të garantuar përkthimin e politikave të mëdha në kushtet konkrete në rajonin që mbulojnë.
2. *Drejtoritë Rajonale të Kulturës Kombëtare - qendra ekspertize në rajon.* Në të gjitha drejtoritë rajonale do të ketë një bërthamë ekspertësh të aftë për të reaguar në kohë dhe profesionalisht ndaj problematikave që mund të dalin në objekt/monument në terren. Kjo skemë do t'i mundësojë Drejtoritë Rajonale të ngrihen në lartësinë e përgjgjësive që i kërkon Ligji për Trashëgiminë Kulturore dhe në përmbushjen me korrektësi të tyre. Bashkëpunimi me Institutin e monumenteve të kulturë dhe institucionet e tjera të specializuara do të jetë intensiv. Brenda strukturave të propozuara të DRKK-ve, është menduar prania e specialistëve të kualifikuar në fushën e restaurimit, arkeologjisë dhe edukimit. Ata, duke qenë se janë të pranishëm dhe bëjnë kontrollin e territorit, ata do të mbajnë në kontroll jo vetëm objektet e shpallura trashëgimi kulturore por edhe potencialin e tyre ende të padalë në dritë.

3. *Instituti i Monumenteve të Kulturës, institucioni shkencor* i sistemit të Trashëgimisë Kulturore do të mundësohet të kryejë detyrat e tij institucionale në fushën e tij kërkimore dhe shkencore, në vendosjen standarteve për ruajtjen, mirëmbajtjen e vazhdueshme dhe restaurimin e trashëgimisë, monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të këtyre standarteve, përmes lirim të IMK nga funksionet administrative të ngarkuara me VKM Nr.983, datë 10.11.2010 Një situatë anormale për profilin e IMK. (Gjithesesi, duke tentuar të godasë një Ligj me të njëjtin objekt, kjo VKM përbën automatikisht, një nul ligjor)

4. *Specialisti Administrator i Trashëgimisë Imateriale dhe Edukimit Kulturor.* Ky është një funksion i ri që i mvishet DRKK për të lehtësuar/mundesuar komunikimin dhe ndërveprimin me (a) konsumatorët e kulturës, (b) shkollat, (c) operatorët e ndryshëm turistikë publikë e privatë, (e) strukturat e arsimit në rajon për hartimin e aktiviteteve, kurrikulave të cilat synojnë në kultivimin e shijeve dhe preferencave kulturore të konsumatorëve të vegjël dhe jo vetëm, (f) Drejtorinë e Përgjithshme të Artit duke garantuar dhe një komunikim të mire në nivel rajoni për çështje të trashëgimisë jomateriale, (g) donatorët dhe NGO etj. Kjo risi është ne perputhje te plote me nje nga objektivat kryesore te Politikes sone kulturore: Edukim permes Kultures.

5. *Mbulimi më i mirë i territorit sipas sistemit* kaskadë. Prane cdo Drejtorie Rajonale do të identifikohen dhe përzgjidhen specialistë që do jenë rezidentë në rrethet përkatëse nën juridiksionin e DRKK. Kjo do të sigurojë (a) një mirëmbajtje të vazhdueshme të monumenteve/objekteve, (b) do të rritë vizibilitetin dhe prezencën e strukturave të trashëgimisë kulturore në një numër më të madh të rretheve si dhe eventualisht (c) shkallën e ndërgjegjësimit të komunitetit për trashëgiminë.

6. *Po rishikohet ne kete kornize numri i Drejtori Rajonale;* Nga 9 DRKK ristrukturimi propozon nje ulje ende te papercaktuar, per te kaluar ne nje sistem menaxhimi me me pak DRKK. Ndër arësytet kryesore për reduktimin e numrit të DRKK mund te rendisim:

- (a) përafrimi i menaxhimit rajonal të trashëgimisë sipas ndarjes se re administrative të territorit të Republikës së Shqipërisë (në proces);
- (b) Përqëndrim i forcave më të kualifikuara në nivel rajoni për t'iu përgjigjur më mirë nevojave në terren;
- (c) ulje e shpenzimeve administrative ne favor të shtimit të numrit të forcave të kualifikuara teknike e mirembajtese;
- (d) shpërndarje më të mirë të punonjësve të DRKK-ve në varësi të shpërndarjes së monumenteve dhe nevojave të tyre në të gjithë territorin e Republikës.

Pjese e reformes është padyshim dhe Ligji Nr. 9048 Datë 07.04.2003, (i ndryshuar) “Për Trashëgiminë kulturore”

Ky ligj ndërkohë ka pësuar dy herë rresht ndryshime dhe për juristët apo njohësit e teknikave legjislative ai nuk mban më arnime të reja, pra duhet riformuluar tërësisht ndonëse është një ligj 10 vjeçar, pra është relativisht i ri.

Janë evidentuar probleme dhe vakume ligjore, të cilat duhen rishikuar pasi nuk gjejnë zgjidhje në ligjin ekzistues dhe as në dispozitat e tjera ligjore në fuqi.

Me lejoni t'ju rendis disa arsye pse duhet ribere ligji për trashëgimie kulturore:

1) Ka disa mangësi që duhen plotësuar për sa i përket konceptit të trashëgimise i cili është një koncept në ndryshim, pasqyrimi i tij është kërkesë për institucionin dhe për kuadrin ligjor. Kështu ligji ekzistues nuk përmend fare pejsazhin kulturor dhe trashëgimie moderne, të cilin e kemi përfshirë tashmë në strukturën e re të ministrise.

Strukturat e reja dhe konceptet e reja që dalin nga kjo reforme duhet patjetër të kenë mbështetjen e tyre në ligjin e ri.

2) Përvoja e ketyre viteve ka treguar se ligji është i paqartë në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të pushtetit vendor lidhur me mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimise së territorit të tyre.

3) Ligji duhet të bëjë një përcaktim shumë më të qartë të kompetencave dhe përgjegjësive të institucioneve të sistemit të TK.

4) Duhen riparë përgjegjësitë financiare të shtetit dhe privateve në restaurimet e objekteve në pronësi joshitetore. Parimet e deritanishme duken të vështira për tu realizuar në praktike dhe behen pengese ligjore për vetë kryerjen e restaurimeve!

5) Duhen riparë më me kujdes të drejtat dhe detyrimet ligjore të koleksionistëve dhe administrimit të koleksioneve private!

7) Besoj se duhet forcuar mekanizmi i kundërvajtjeve dhe penalizimeve në ligjin ekzistues, pasi përvoja ka treguar se mekanizmat ekzistues nuk e mbrojnë sa duhet shkatërrimin e qëllimshëm të trashëgimise, etj.

8) Të pesë konventat UNESCO-s në lidhje me trashëgiminë kulturore, nuk gjejnë një pasqyrim të denjë. Nuk janë asimiluar mirë madje edhe në rastet kur kemi të bëjmë me çështje specifike të mbrojtjes së trashëgimise kulturore. Jo vetëm për faj të hartuesve të ligjit por edhe për arsyen se vetë konventat paraqesin mbivendosje

9) Po kështu, lëvizja e objekteve kulturore do të jetë në fokus të kësaj nisme ligjore. Në këndvështrimin ligjor bazuar edhe në Planin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit 2007-2012 ligji duhet të parashikojë procedura të veçanta për lëvizjen e lirë të mallrave kulturorë. Deri më sot ligji ka parashikuar vetëm një dispozitë pika 3 neni 19 i ligjit e cila është konkretizuar me daljen e udhëzimit të Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve nr. 2, datë 18.03.2004 “*Për procedurat e lëvizjes së objekteve të trashëgimise kulturore, të luajtshme, me vlera të veçanta, kombëtare dhe unike, për ruajtjen, restaurimin, studimin dhe ekspozimin jashtë territorit të RSH*”. Ndërkohë që Plani Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit ngarkon shtetin shqiptar me detyrimin e përafritimit të ligjit për trashëgiminë kulturore por edhe ligjit për muzetë me Direktivat e Parlamentit Evropian dhe Këshillit më konkretisht Direktivën 93/7/EEC; Direktivën 96/100 EC; Rregulloren 3911/92 dhe Rregulloren 752/93¹.

Ky detyrim nuk është zbatuar megjithëse ligji për trashëgiminë kulturore është prekur nga ndryshimet në vitin 2009.

10. Trashëgimia Imateriale është një nga elementët shumë të rëndësishëm por shumë pak i trajtuar në legjislationin ekzistues, një element që është shpërfillur, gati inekzistent. Në nenin 6 të ligjit parashikohet ngritja e Komitetit Kombëtar të Trashëgimise Kulturore Shpirtërore si subjekt që mbikëqyr veprimtarinë në fushën e trashëgimise kulturore jomateriale, si dhe realizon strategji dhe programe të zhvillimit në këtë fushë. Ky është rregullimi i vetëm ligjor

¹ Plani Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, Këshilli I Ministrave 2007, faqja126

për këtë pjesë të trashëgimisë i cili kurrsesi nuk mund të implementohet po nuk u parashikuan struktura të cilat do të zbatohet dhe politikat konkrete në këtë drejtim.

Per here te pare i lihet nje drejtori me vete ne strukturen e re Trashegimise Imateriale e cila ka per synimin pikerisht perfshirjen e vlerave te panumerta te kesaj Trashegimie

Duhet të theksoj se shteti ynë ka ratifikuar me Ligjin nr. 9490, datë 13.3.2006, Konventën për ruajtjen e trashëgimisë kulturore jomateriale, Paris 2003. Kjo konventë, trashëgiminë shpirtërore e trajton të veçuar dhe ngarkon dhe shtetet palë të saj (siç është Shqipëria) të marrin masa të nevojshme për të siguruar ruajtjen e trashëgimisë shpirtërore jo materiale të pranishme në territorin e secilit vend.

Dhe me “ruajtje” nënkuptohet jetëgjatësia e kësaj pjese të trashëgimisë kulturore përfshirë (identifikimi, dokumentimi, kërkimi, mbrojtja, vlerësimi, nxitja përmes edukimit formal dhe joformal, si dhe rigjallërimi i aspekteve të ndryshme të kësaj trashëgimie).

11) Trashëgimia nënujore

Në Paris të vitit 2001 në Konferencën e Përgjithshme të Organizatës Arsimore, Shkencore dhe Kulturore e Kombeve të Bashkuara është miratuar Konventa për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore nënujore e cila është ratifikuar nga shteti shqiptar me ligjin nr. 10027 dt. 11.12.2008. Në asnjë dispozitë të ligjit në fuqi nuk parashikohet një rregull i posaçëm në lidhje me aktivitetet e drejtuara ndaj trashëgimisë kulturore nënujore përfshirë elementë të mbrojtjes si dhe të kushteve dhe kriterëve të kërkimeve nënujore nëpërmjet në përputhje Konventën në fjalë.

Në reformën ligjore të trashëgimisë kulturore, Trashëgimia kulturore nënujore do të ketë rregullim të posaçëm si në përkufizim ashtu edhe në vendosjen e rregullave për ushtrimin e aktiviteteve në këto zona. Kjo për të parandaluar dëmtimin e arkeologjisë nënujore nga subjekte private. Do të përcaktohen masa shtrënguese kundrejt subjekteve që do të cenojnë këtë trashëgimi të pasur të vendit. Është e domosdoshme që të hidhen bazat e një strukture e cila në të ardhmen e afërt do të menaxhojë të gjithë territorin nënujor shqiptar për çështjet e trashëgimisë kulturore. Në këtë mënyrë do të ketë një hov të mëtejshëm të zhvillimit të trashëgimisë nënujore.

12) Për sa i përket parashikimeve të bëra në ligj për kundërvajtjet administrative, mendoj se përcaktimi i masës së gjobave duhet të jetë në nivel më të lartë në rastet e dëmtimeve të nëntokës dhe monumenteve të kulturës. Rritja e nivelit të gjobave, sugjerohet si një element frenues i aktivitetit të subjekteve fizikë dhe juridikë që dëmtojnë direkt ose indirekt objekte të trashëgimisë kulturore. Me këtë rritje synohet ndërgjegjësimi i mëtejshëm i komunitetit për vlerat e trashëgimisë kulturore. Nga eksperiencia e deri tanishme ka rezultuar se gjobat e vendosura subjekteve private nuk e kanë frenuar aktivitetin e tyre duke e thelluar edhe më tej gjendjen e objekteve monument kulture.

Këto janë disa nga arsyet për të cilat mendoj se ligji për trashëgiminë kulturore së bashku me aktet nënligjore në fuqi ka nevojë të rishikohet, pasi diktohet jo vetëm nga direktivat e BE dhe konventat ku Shqipëria është palë, por edhe për faktin se në gjendjen aktuale ku jemi, kërkohet një riorganizim rrënjësor për një menaxhim të ri të trashëgimisë në funksion edhe të turizmit kulturor sipas strategjisë së qeverisë

13) Ligji nuk është në harmoni me një sere ligjesh kombëtare të tjera në fuqi si me atë të Buxhetit, Planifikimit të Territorit, Turizmit etj

14) Raporti partneritetit shtet privat është shumë i paqartë sikurse janë të paqarta kompetencat ne pronesi dhe administrim të pronave e komuniteteve fetare që përbëjnë vlerë te TK.

Për këto arsye politika për realizimin e një reforme në trashëgiminë kulturore në këtë këndvështrim do të përfshijë hartimin e një ligji të ri për trashëgiminë kulturore, çka do të kryhet me patjetër në bashkëpunim me ekspertë dhe juriste të fushës të cilët janë të ndjeshëm ndaj fenomeneve të ndodhura deri më sot në vendin tonë. Kjo punë ka filluar brenda në Ministri dhe shpejt do të jetë diskutim i nje grupi pune te posaçëm.

Të nderuar deputetë, ndjesë nëse u zgjata shume, por mund të isha zgjatur edhe më shumë sepse ia vlen dhe duhet.

Ajo dua të them është se nëse André Malraux të cilin Gjenerali De Gaulle e bëri Ministër të Punëve të Kulturës në vitin 1959, duke krijuar kështu për të parën herë një ministri për PUNET E KULTURES thoshte se "Kultura i dha mundësinë njeriut të mos mbetej një aksident i universit,"

kemi detyren paresore qe te punojme te gjithë bashke qe Kultura te mos kthehet ne nje aksident te njeriut shqiptar.